

Fjala e Kryetares së Autoritetit, Dr. Gentiana Sula në seancën plenare i veprimtarisë së [#AIDSSH 2023](#):

Ekspozimi i të vërtetave historike, drejtësi për të zhdukurit, rishqyrtim dhe edukim

-Arritjet, sfidat dhe e ardhmja e institucionit

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të detyrave që ligji nr. 45/2015 i ndryshuar, i ngarkon Autoritetit, është përgatitur Raporti Vjetor 2023, në të cilin pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur veprimtaria e institucionit.

Është tashmë e ditur që e vërteta është viktima e parë në periudha të traumave të historisë. që i jep shans miteve të rremeve krijuar përmes historiografisë së deformuar. Qëllimi i gënjeshtërve historike – thotë Hannah Ahrend – nuk është t’i besosh ato, por të mos besohet në asgjë nga askush, që të vritet përmes të vërtetës dhe shpresa për ndryshim.

Ky raport dokumenton punën e kryer për t’i shërbyer çmontimit të miteve të rreme dhe ekspozimit të së vërtetave të çdo dite; këto përmes një përmirësimi të cilësisë dhe shpejtësisë në shërbimin e dokumenteve, bashkëpunimin e zgjeruar e të qëndrueshëm me institucione si brenda dhe jashtë vendit, drejt realizimit të qëllimeve të përcaktuar në ligj si:

- ai i mundësimi të rishqyrtimit historik të policisë politike si Ish-Sigurimi i Shtetit, por dhe i narrativave familjare, personale, të grupeve me cilësi të posaçme që u targetuan si kundërshtar apo armiq të kohës.

- të edukimit qytetar për demokraci në një koncept me të gjerë, sidomos për moshat shkollore.

AIDSSH ka qenë e vetëdijshme për vlerën e njohjes së kostove njerëzore, shoqërore, politike pse jo dhe kombëtare të diktaturës 50 vjeçare që ka ende sot ka një trashëgimi masive jodemokratike, dhe që ka nevojë të rishqyrtohet në mënyre kritike për reflektim me sytë nga e tashmja dhe ardhmja.

Ky vit ishte i rëndësishëm në disa drejtime **të reja** por thelbësore, të cilat qëndrojnë në themel të misionit dhe vizionit të Autoritetit për të ardhmen:

1) Modernizim i arkivës, indeksim dhe organizimi i koleksioneve të saj, konceptimi i kartotekës.

2) Marrëdhënie të ngushta me përdoruesit e arkivës, shërbim me i shpejtë dhe më i plotë sidomos ndaj palëve të prekura për shanse më të rritura të qasjeve në politikën e programet rehabilituese dhe ato të kujtesës dhe përkujtimit.

3) Avancim i procesit të kërkimit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve dhe ekzekutuarve, si dhe arritja e rezultateve të parashikuara, dhe

4) Argumentimi dhe konkretizimi me sukses i bashkëpunimit zyrtar me MAS për përfshirjen në kurrikulën e arsimit parauniversitar të informimit mbi aktivitetin e ish-Sigurimit të Shtetit. Konceptimi dhe vënia në funksion i platformës “*Mësojmë nga e kaluara, burime arsimore të hapura 1944-1991*”, një platformë interaktive me burime parësore si arkivë, dëshmi gojore, etj., e cila po bën bashkë aktorët e kujtesës dhe ekspertët e arsimit, me qëllim edukimin për

qytetari demokratike. Themelimi, në këtë kuadër i aktiviteteve periodike si Klubi Librit, Arkiva e Hapur, Dosja e Hapur, Leksione te Hapura,

Sa më sipër, një konsolidimi institucional u parapri pasi parlamenti miratoi ndryshimet në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në dhjetor të vitit 2022, ku pa humbur kohe, organi kolegjal miratoi aktet nënligjore që e bënin të zbatueshëm këtë ligj. Kështu :

- U miratua Plani Strategjik për periudhën 2023-2028 një dokument i gjallë i dakordësuar me grupet e interesit.
- U përgatit dhe u miratua, Udhëzuesi “Për rregullat dhe procedurat e verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;
- U miratua tashmë shtesa dhe ndryshimi në Rregulloren për Organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së si dhe është rishikuar strukturë.

Aktiviteti i AIDSSH-së në statistika

Pa arkivën shumë histori të njerëzve do të kishin humbur dhe bashkë me to fakte e të dhënat kritike që na lejojnë të reflektojmë dhe interpretojmë jetën tonë sot dhe na ndihmojnë për të marrë vendimet e duhura në këtë botë të trazuar.

Arkivi i Ish-Sigurimit të Shtetit është një arkiv i diktaturës, Shqipërisë së izoluar staliniste satelit në kampin lindor sovjetik deri në 1991, arkivë e shkeljes së drejtave të njeriut. Nëse kjo arkivë shfrytëzohet siç e përcakton ligji, na përball dhe pajton me të shkuarën, na formon dhe transmeton kujtesën drejt një përkujtimi emancipues demokratik të vlerave perëndimore, na zbulon të vërtetat e mohuara me dekada, përmirëson pozicionin e familjeve të përndjekura në shoqëri, dhe nxit llogaridhënien dhe krijon pika referimi të rëndësishme për moralin e shoqërisë.

Ndaj gjatë vitit 2023 jemi angazhuar për grumbullimin e vazhdueshëm të dokumentacionit arkivor, me modernizimin e arkivës përmes krijimit të një sistemi të arkivës digjitale (softëare), digjitalizimin e konceptimit të një sistemi për indeksimin e dokumenteve arkivore, skanimin masiv të tyre, konceptimin dhe plotësimin e koleksioneve arkivore sipas tematikave që shfaqin interes parësor, zhvlerësim të sekretit e zbardhje të inventarëve, dhe konceptimin e një sistemi të publikimit të arkivës, që e kemi pagëzuar “Mediatekë” – në respekt të homologut gjerman. Një arkiv sa më plotë dhe e sistemuar, krijon kushte për akses të papenguar në dokumenta.

Grumbullimi i dokumentacionit të hartuar nga ish-Sigurimi i Shtetit vijon. Kemi tërhequr 5 fonde nga Ministria e Brendshme dhe presim edhe 36 të tjera. Me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave vijon komunikimi për disa fonde. Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se nuk disponon dokumente të ish-Sigurimit ndërsa Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor (AQSGJ), shprehet se arkivat e disa prej gjykatave janë në proces përpunimi.

Me ndryshimet ligjore, e shprehur në statistika, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë marrë **21** Vendime të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit **5,591** njësi arkivore (dosje, fashikuj etj.) prej **237,259** fletë dokumente arkivore brenda vitit, inventarët e të cilëve janë publikuar në fletoret zyrtare e në buletinet e AIDSSH.

Janë dyfishuar dosjet fizike të digjitalizuara në krahasim me një vit më parë, **2113** dosje fizike nga **1019** në vitin 2022, **175** dosje të mikrofilmuara, me një total prej **158 268** faqe dokumente arkivore si dhe ka nisur skanimi masiv i dokumenteve **me afro** 1.500.000 imazhe, kjo me kontraktim me palët e treta.

Shërbimi më i rëndësishëm është ai i drejtpërdrejtë ndaj palëve të prekura.

Dhimbja na bën njerëz dhe na bashkon me njëri- tjetrin. Kjo premisë e punës në AIDSSH po sjell edhe zërin e qëndrimin e viktimës, solidaritetin njerëzor përmes sakrificash, duke ndihmuar krijimin e kuadrit të plotë historik të diktaturës, dhe përcimin e saj brenda familjes dhe me gjerë.

AIDSSH, me këtë proces informimi po ndihmon qasjen në politikat e programet rehabilituese si dëmshpërblim e pensioneve, si dhe një pjesëmarrje kumbuese të familjeve të shtresës, të pajisur me narrativë të bazuar në fakte. Kjo qasje nderon viktimat dhe nuk lejon mohimin e krimeve dhe shkeljen e të drejtave në diktaturë, por i dokumenton ato.

Kështu janë regjistruar **457** kërkesa individuale të reja dhe mbyllur **509** kërkesa individuale të mbartura. Nga këto **10** kërkesa janë për zbardhje bashkëpunëtorësh. Do doja të ndalesha pak këtu, sepse kjo është një punë shumë voluminoze e natyrës hulumtuese, e cila përveç se po i përgjigjet kërkesës së personave tëurvejuar në mënyrë të fshehte, po qartëson përditë e me shume natyrën e punës së Sigurimit të Shtetit, ideologjinë, motivimin, format e punës dhe pasojat e saj në jetën e kundërshtarëve politikë apo të atyre që perceptoheshin si të tillë.

Për të ndihmuar proceset e përlllogaritjes së pensioneve është bashkëpunuar në 59 raste me ISSH dhe në 113 raste me qytetarë, të mbijetuar.

Kujtimet e vëna në provë, ballafaquar me dokumentet. JANE KUMBIM i zërave të mohuara. Janë kumti i atyre por edhe i këtyre kohërave. Ato mund të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë dokumentet e sigurimit, në zbutjen e kontrasteve dhe dritëhijeve të historisë.

Ndaj për të sjellë këndvështrimet dhe burime private lidhur me dokumentet që disponohen, vijon procesi i mbledhjes së dëshmimeve gojore. Mund të na ndihmojnë në konvergimin e te vërtetave tona dhe kujtime të larmishme e shpesh antagonistë, ku “armiqtë e popullit” u përballën me stigmë, procese të montuara politike, padrejtësi e diskriminim ndërbreznor, kurse pjesa tjetër u përkund në utopi apo besoi në propagandë.

Nëpërmjet informimit AIDSSH mbështet dhe **studimin shkencor dhe mediat. Janë regjistruar** 112 kërkesa studimore/mediatike, **83** studiues kanë konsultuar dhe kanë tërhequr vendimet dhe dokumentacionin shoqëruar pranë zyrave të Autoritetit. Janë vënë në **dispozicion 1329 dosje**, me rreth **138 010 faqe**, ndër të cilat rreth **10 522 faqe** kanë kaluar në proces anonimizimi.

Në kuadër të bashkëpunimit me ISKK i janë vënë në dispozicion të 70 njësi arkivore dhe janë hartuar draft-marrëveshjes mes palëve, për çështje të përbashkëta të interesi në studimin e

krimeve të komunizmit. Puna në këtë drejtim na çon drejt rishqyrtimit historik të figurave historike, ngjarjeve të shënuara në nivel bashkësie apo vendi. Në të dy drejtimet puna është dakordësuar në organ kolegjal dhe ka filluar.

Është hartuar një kalendar kujtese në ngjarjet e shënuara, listë e cila përditësohet me gjetjet e reja, apo propozimet. Ky do të jetë dhe një ndër dokumentat bazë qoftë për platformën shkollore e mësimin nga historia, qoftë për publikimin e koleksioneve arkivore, që do sillen rreth ngjarjeve.

Konform kësaj janë realizuar **49** aktivitete, dhe konferencat apo simpoziumet që sjellin prurje substanciale dhe dokumentohen, sot që flasim, në mënyrë kumulative, me 50 botime në letër dhe online;

Për herë të parë botohet një libër për nxënës të arsimit parauniversitar me infograma, kronologji apo objekte dhe sende të përdorimit të përditshëm në Spaç. Planet janë konkrete që për 2024 të përgatiten libra didaktike për punën e detyruar, të papaguar dhe kalimet e ndaluara te kufirit, duke portretizuar ngjarje të vërteta dhe përjetime të fëmijëve të asaj kohe.

Po provohet çdo ditë, që jo thjesht evidentimi, por dhe ekspozimi i të vërtetave historike, e nxit rishqyrtimin e historisë dhe edukimin mbi të. Metoda e përdorur deri me sot fillon si **hap i parë** me evidentimin e fakteve të reja dhe organizimin e koleksioneve arkivore për ngjarjen apo personazhin historik, apo për trevën, më pas si **hap i dytë** me ekspozimin e të fakteve ndaj partnereve të specializuar, studiuesve dhe familjarëve, për të evidentuar me tej dëshmi të dorës së parë apo burime dytësore, dhe si **hap i tretë**, organizimi i shumëpalësh i simpoziumit apo konferencave tematike, të cilat përfundojmë me botim apo faqe ëëb, apo të dyja, si **hap i katërt dhe përmbyllës**.

Në këtë drejtim Autoriteti ka realizuar **4 ekspozita të burimeve arkivore** si ekspozita me dokumente për hebrenjtë në Shqipëri e Kosovë, ajo mbi lëvizjet demokratike 1990-1991; mbi kampin e punës së detyruar e papaguar në Spaç, revoltën, vendimet penale me vdekje dhe ridënimet, për të vijuar me ekspozitën “TË ZGJEDHUR “*organizuar në 76 vjetorin e ekzekutimit politik të deputetëve opozitarë, në vitin 1947, mbështetur në dokumentet tona arkivore, me ekspozimin e kronologjisë aq domethënëse të fatit të gjithsecilit, në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë dhe Institutin e Studimeve Parlamentare.*

Vitin 2023 e nisëm me aktivitetin,(arkivë- studim) mbi “*Sfidat e mësimdhënies së historisë dhe roli i shqiptarëve në shmangien e ndikimit të Holokaustit në Shqipëri, Kosovë.*” ku angazhuam mësuesit e historisë për t’u qasur dokumenteve dhe vlerësimit të disa data historike, siç ajo e Ditës që përkujton Holokaustin, një histori tragjike e hebrenjve e ngjashme me mënyrën se si u trajtuan njerëzit në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit.

Këtu me fakte e me prova të lexuara për herë të parë, si ato individuale për çdo hebre të Shqipërisë, apo ato të gjyqeve speciale të pasluftës apo të dosjeve të elitës shqiptare të L2B u vërtetua jo vetëm mungesa e persekutimit ndaj hebrenjve në një luftë famëkeqe për këtë fakt, por dhe mbrojtja aktive, me pasoja të mundshme, që u aktivizuan ndaj qytetareve, hebrenj, gjë që na bën krenarë.

50 vjetori i Spaçit me hapjen e dokumenteve, sollu produkte nga pas, analiza nga ekspertë të minierave dhe studiues, mbi punën e detyruar por të papaguar, fatin e sektorit të industrisë, gjatë diktaturës dhe menjëherë pas ndalimit të shfrytëzimit skllavëror të punës së të dënuarve politike, mbledhjen e 60 dëshmimeve shumë të çmuara, ekspozitën “Gjurmë qëndrese dhe

solidariteti” qe solli fatet e familjarëve të të dënuarve të Spaçit me gjithë stigmën, përjashtimin dhe pasojat e famëkeqes **Luftë Klasash**. Ky projekt i AIDSSH-së u zhvillua në bashkëpunim me grupet e interesit, shoqatën e ish- persekutuarve, dhe u nderua me prezencën e Presidentit të Republikës, Z. Bajram Begaj. Si dhe kulmoi me prodhimin e një dokumentari të shkurtër për fëmije, dhe dy botimet akademike dhe didaktike, për të rritur dhe fëmije.

Shqyrtimin e figurave historike e nisëm me aktivitetin: “DOSJA E HAPUR”, ku me analizën e dokumenteve te ekspozuara si dhe zërat e familjarëve për Xhahit Toptanin dhe Abdyl Këllezi, historiani Gjon Boriçi solli dy figurat në dukje antagonistë me njëra –tjetrën, por me fat të përbashkët. Aktiviteti i ngjashëm do vijojë me figura të tjera historike të kohës, në prezencë të familjareve dhe biografëve të tyre.

Një investim në dije, jep fitimin me të lartë. Me platformën, fitimi është edukimi për demokraci. Kështu i hapëm rrugën një objektivi edhe më të madh ku së bashku me Ministrinë e Arsimit, gjatë përkujtimit të një dite të rëndësishme për shqiptarët si 20 Shkurti i viti 1991, ditën e rrëzimit të shtatores së diktatorit, prezantuar idenë dhe nevojën për ngritjen e **Platformës digjitale “Të mësojmë mbi të shkuarën - burime arsimore të hapura 1944-1991”** me qëllim edukimin me historinë e së kaluarës përmes dokumenteve dhe dëshmive. Aty ekspozuam foto, dokumente arkivore apo filmime të kësaj dite, qe dëshmon dhe faktin se diktaturat rrëzohen nën peshën e vet, duke lënë pas dhembje dhe shprese

Sidoqoftë, Shqipëria ka një histori mes asaj të Europës Lindore Qendrore, jemi të vetëdijshëm që të mësojmë nga përballja me të keqen që kanë arritur vende që janë më pranë nesh, apo dhe organizata ndërqeveritare. E mbyllëm vitin 2023 me sigurimin e mbështetjes së një partneri si KiE , me të cilin realizuam në Tiranë Simpoziumin Ndërkombëtar me temë: “*Mbi përdorimin e dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit për mësimin e historisë së regjimit totalitar në edukimin për demokraci në shkollë.*”, ku bashkë me Ministrinë e Arsimit, institucionalizuam platformën, e cila na vendos në një stad me zhvillimin e programeve të ngjashme të kujtesës në botë.

Hetimet administrative- Drejtësi për të zhdukurit dhe heqja e stigmës mbi figura të shquara historike

Autoriteti ka përdorur për herë të parë hetimin administrativ si një standard shqyrtimi për të gjitha rastet si a)kur kërkohet **korrigjimi** i një vendimi apo informacioni të dhënë apo bërë publik; b)kur vlerësohet i nevojshëm **verifikimi** për qartësimin dhe plotësimin e dokumentacionit mbi ngjarje apo figura historike, c)kur nevojitet verifikimi për qartësimin e vendeve të dyshuara, në funksion të identifikimit dhe rikuperimit të të zhdukurve dhe të ekzekutuarve, kërkuar nga familjarët.

Kështu gjatë vitit 2023 janë zhvilluar:

-tre hetime administrative për verifikimin e dyshimeve për vendavarrime të pashenjuara të mundshme, dhe

-dy hetime administrative për verifikimin e vërtetësisë si dokumente arkivore , ende në vijim.

në rastin e shqyrtimit të një figure historike

në kuadrin e ankesës së një qytetari për korrigjim dokumentesh,

Të nderuar deputetë,

Të vdekurit nuk mund të vajtojnë për drejtësi është detyra e të gjallëve ta bëjnë atë. AIDSSH po përpiqet me mish e me shpirt për të siguruar një mekanizëm rehabilitues, sa më efektiv, për të gjithë ata që pësuan padrejtësi duke u përballur me vdekjen, por pa u sistemuar në një varr njerëzor dhe të shënjuar. E drejta ndërkombëtare humanitare i quan ato TE ZHDUKUR dhe nuk i privon nga e drejta e varrit, e as familjet e tyre nga e drejta mbi të vërtetën dhe atë të përmbylljes së zisë. Përkundrazi, kjo përkufizohet si një vuajtje e ngjashme me torturën e pafund. Kurse fshehja e fakteve të njohura për vendndodhjen e kufomës, klasifikohet si një vepër penale. AIDSSH është në anën e familjarëve në këtë përpjekje të vështirë por jo të pamundur të kërimit të të afërmeve të tyre, apo dhe thjesht qartësimin të fatit të tyre.

Të afërmit e tyre humbur jetën qoftë në kampet internimit, ato të punës së detyruar, të dënuarim me pushkatim, të vrarët gjatë kalimit të ndaluar të kufirit, kërkojnë të kthehen pranë varreve të afërmeve.

Procesi ende i papërfunduar i kërimit dhe gjetjes të zhdukurve në komunizëm ka ndikuar rëndë në shpresat e familjeve të tyre. Edhe pse kanë kaluar tre dekada nga rënia e regjimit, shumë familje ende nuk kanë gjetur paqe dhe mbeten të zhytura në dhimbje për fatin e të afërmeve të tyre. AIDSSH i bën thirrje që ata të bëjnë detyrën e tyre të mos humbjes së shpresës, sepse me humbjen e shpresës do të ushqejnë harresën, dhe mohimin, dhe duke i falënderuar për durimin dhe përkrahjen e vazhdueshme ka vijuar me hetimet për të siguruar që çdo trup njerëzor i pagjetur të kërkohej, dhe çdo dyshim për vendvarrime të pashenjuara apo sekrete të hetohet.

Gjatë vitit 2023, nga të afërm të personave të zhdukur, janë depozituar **57 kërkesa**, nga të cilat **39 rezultojnë me të dhëna arkivore, ndërsa 9 kërkesa pa të dhëna**. Të tjerat janë në proces. Janë realizuar 3 hetime administrative mbi këtë temë, 6 inspektive në vendvarrime të dyshuara, shenjëzimi i një vendvarrimi në Shkodër pranë varrezave të Rrmajit

Nisur nga kërkesat e familjarëve të të zhdukurve lidhur me vrasjet në kufi, me vendim të Autoritetit nisi verifikimi i vendit të dyshuar si vendvarrim për shtetasin Dhimtër Koni, në kalimin kufitar Shelegurë, Leskovik. Ky hetim dhe dëshmitë e mbledhura në këtë zonë po e drejtojnë institucionin drejt studimit të thelluar të kalimit të ndaluar të kufirit dhe pasojat e tij tragjike, simpozium që planifikohet të zhvillohet në kuadrin e ditës ndërkombëtare të zhdukurve në gusht 2024.

Vijam me hetimin administrativ, me qëllim qartësimin e fatit, kërkimin, gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të **zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit**; lidhur me këtë është identifikuar vendvarrimi i mundshëm ku mund të jenë eshtrat e 4 të pushkatuarve të Revoltës së Spaçit, **Skënder Daja, Pal Zefi, Dervish Bejko dhe Hajri Pashaj**, Në bashkëpunim me pushtetin vendor, zona është pastruar dhe në të mund të kryhen kërkime dhe gjurmime për eshtrat e tyre. Po ashtu është pastruar territori i vendvarrimit

të dyshuar të Shpalit në Mirditë. Sipas dëshmive aty ka eshtra të të zhdukurve, të vvarë apo vdekur në Burgun e Spaçit.

Vijam me verifikimin e thelluar administrativ, me qëllim identifikimin e vendvarrimeve të personave të vdekur ose të zhdukur në Shkodër. Nga verifikimi i hetimit administrativ janë evidentuar vendvarrime të dyshuara si: *Pranë varrezave të Rrmajit*, vendvarrim i dyshuar për grupin e të pushkatarëve në 4 maj 1946. *Në drejtim të kupolës së varrezave të Rrmajit*, ku dyshohet se është vendvarrimi i eshtrave e Prek Calit dhe 14 të pushkatuarve gjatë regjimit komunist, në 25 Mars 1945, *“Tek Antena” në Kuç të Shkodrës*, ka qenë vend që janë bërë pushkatime gjatë regjimit komunist, *“Varri i Jahës”*, është një terren i pandryshuar në vite i cili ndodhet në Njësinë Administrative Gruemirë të Malësisë së Madhe. Nga informacioni i mbledhur deri tani, vendvarrim tjetër i dyshuar është *“tek Artistikja në Shkodër”*. Inspektimet kanë vijuar në bazë dëshmive të familjarëve edhe në Mallkeq, Bashkia Selenicë, Shën Vasil bashkia Sarandë, fshati Vorfë.

Ndërkohë që kemi bërë qartësimin e fatit nuk po bëjmë hapa përpara për sa kohe pritet ende miratimi i VKM, “Për gjetjen, identifikimin, rikuperimin e eshtrave dhe mënyrën e mbrojtjes e ruajtjes së vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë periudhës 29 nëntor 1944-2 korrik 1-991, miratimi i hap rrugë procesit të gërmimeve dhe kam bindjen që përcillet nga mbarë shoqëria si arritje humane.

Verifikimi i figurave- Të votojmë njerëz të pashantazhueshëm

Publiku shqiptar duhet të njohë kandidatët për detyra të larta dhe të votojë i lirë, i qetë dhe i informuar. Duhet kuptuar që debati për të shkuarën nuk është i plotë pa verifikimin e figurave,

Kështu puna jonë për verifikimin e figurave ka vijuar, për periudhën janar – dhjetor 2023, janë verifikuar **257** kandidatë nga të cilët vetëm **14** prej tyre figurojnë në dokumente të Ish-Sigurimit të Shtetit.

Për vitin 2023 janë paraqitur gjithashtu me iniciativë personale katër kërkesa për verifikim nga **deputetë në detyrë të Kuvendit të Shqipërisë**.

Me rastin e zgjedhjeve vendore të datës **14 maj 2023**, edhe pse Autoriteti ka përcjellë shkresa pranë 50 subjekteve politike apo koalicioneve të regjistruara, janë paraqitur vetëm dy kërkesa një nga kandidati për Këshillin Bashkiak Vlorë dhe tjetra nga kandidati për Këshillin Bashkiak Krujë.

Vijon të mbetet problematikë mungesa e bashkëpunimit nga ana e subjekteve politike, që çon në mos zbatim të detyrave ligjore të ngarkuara sipas përcaktimeve të nenit 30 të ligjit. Paketa me propozime e dorëzuar nga Autoriteti për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor do të krijojë hapësirën ligjore që të kryhet verifikimi i gjithë kandidatëve që kandidojnë në zgjedhje.

Së dyti, lidhur me verifikimin e figurave të zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie figure, në zbatim të Rezolutën e Kuvendit ku rekomandohet që Autoriteti të bashkëpunojë me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike me qëllim që t’i drejtohen Autoritetit me

kërkesë për **ri - verifikim të figurës** së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie” deklarojmë se :

Autoriteti ka identifikuar 13 zyrtarë në 6 institucione, për të cilët Autoriteti nuk kishte kryer procedurë verifikuese pasi kandidatët dispononin certifikatë të pastërtisë së figurës, për shkak të pengesës ligjore.

Sa më sipër në rrugë shkresore u kërkua bashkëpunimi nga të 6-të institucionet e konstatuara, mbi kandidatët konkretë për të cilët Autoriteti nuk kishte kryer procedurën verifikuese, në përgjigje të cilave rezultoi se:

- 1 kandidat i MEPJ është liruar nga detyra për efekt të moshës së pensionit.
- 1 kandidat i KLGJ-së, nuk është emëruar në ndonjë detyrë nga ana e KLGJ.
- Për 4 kandidatët e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, dy prej tyre nuk janë më në Policinë e Shtetit, e dy zyrtarët e tjerë nuk janë subjekte verifikimi sipas ligjit nr. 12/2018.
- Kandidati i Gjykatës së Rrethit Vlorë, shkualifikuar nga vettingu.
Dy institucione nuk kemi ende përgjigje zyrtare

Ky ndryshim ligjor ka dhënë rezultat pasi në vitin 2023, për një kandidat të pajisur më parë me certifikatë pastërti figure, pas ri-verifikimeve kandidati figuroi në detyrën e prokurorit në një çështje penale politike. Gjithashtu, autoriteti u investua për një raport mbi qasjen krahasuese të verifikimit të figurave mes komisioneve të mëparshme dhe të standartit të ligjit 45-15 dhe gjeti të dhëna të rëndësishme që informojnë trashëgiminë e Ish-Sigurimit të Shtetit në periudhën tranzitore, fakte të cilat janë bërë dhe publike, në formë statistike, për sa kohë ende dokumentet burimore që janë prodhuar nga SHISH janë të padeklasifikuara.

Prandaj në këtë kuadër kërkojmë bashkëpunimin e forcave politike apo komisionit të reformës zgjedhore. Autoriteti përsëri ka paraqitur propozime për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor që do të krijojnë hapësirën ligjore që lejojnë të kryhet verifikimi i të gjithë kandidatëve që kandidojnë në zgjedhje.

Të nderuar deputetë,

Shpesh debatojmë mes nesh mbi modelet fisnike të shoqërisë, dhe konkludojmë që modeli fisnik është ai që ndihmon të zgjidhin hallet apo në plotësimin e nevojës së dikujt tjetër, qoftë dhe përmes sakrificës së vet, pa llogaritur përfitime personale. Po ashtu, kush dëmton të tjerët, në emër të pushtetit dhe privilegjeve të veta, nuk mund të jetë model fisnik i shoqërisë. Ne shpresojmë që në kërkim të modeleve të shoqërisë, çdo entitet që lëshon medalje, nderime, emra rrugësh dhe shkollash, të jetë i informuar në vendimet për këto nderime, sepse kjo do të ndikojë në modelet frymëzuese që zgjedh shoqëria jonë sot e në vijim. Në aspektin njerëzor, këto nderime nuk duhet të rizgjojnë dhembjet apo dasitë e vjetra.

Në total këtë **vit u verifikuan 40 kandidatë për tituj nderi dhe 10 prej tyre figuruan** në arkivat e AIDSSH. I takon pushtetit vendor të largohet nga modeli i thashethemeve apo simplifikimit të fakteve, që të njihet e të hulumtoje me kujdes rolin e secilit, tashmë të informuar dhe të krijojë kushte që këshillat bashkiake të marrin vendime sa më të vlefshme për komunitetin e tyre.

Sot ka një numër në rritje të bashkive (10) që bashkëpunojnë me AIDSSH për të verifikuar kandidatët për nderime e medalje. Po përsëri ky numër nuk është i plotë.

E këtu dihet që neutraliteti ndihmon shtypësin, asnjëherë viktimën.

Autoriteti ka bërë propozime edhe për ndryshime në projektligjin për dhënien e dekoratave, ku të parashikohet një dispozitë detyruese për organet e pushtetit vendor dhe atyre që merren me nderimet të punojmë me institucionin tonë në drejtim të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.

Një element tjetër i pazëvendësueshëm i kujtesës janë **vendet e vuajtjes. Kujtesa lidhet pazgjidhshmërisht me vendin e vuajtjes.**

Në këtë kuptim, muzetë dhe memorialët e kujtesës përfaqësojnë një homazh për viktimat e padrejtësive dhe tragjedi të së kaluarës. Përmes tyre nderojmë jetën atyre që ishin në kërkim të lirisë dhe dinjitetit njerëzor, ndërgjegjësojmë publikun dhe edukojmë brezat e ardhshëm mbi rëndësinë e lirisë , drejtësisë dhe respektit për të drejtat njerëzore.

Në këtë drejtim puna AIDSSH-së vijon me planet për realizimin e një memoriali në Ersekë në nderim të të vrarëve dhe të zhdukurve në kufi si dhe ndërtimit të një varreze monumentale në Tiranë për të zhdukurit nga diktatura, ekzekutuar apo vrarë e vdekur në situata të pahetuara në burgje, kampe, hetuesi, kufi.

Propozimet e Autoritet në ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për përfshirjen në ndërtimin e Muzeut Kombëtar “Kampi i Punës së Detyruar të të Burgosurve Spaç” dhe Muzeu Kombëtar “Kampi i Internimit me Tela me Gjemba Tepelenë”, ende nuk janë miratuar.

***Si përfundim** Autoritetit sot, pas 7 vitesh, nuk është vetëm një arkivë sekrete që po hapet, por dhe një arkivë e panjohur me parë që na bën të njohim me mirë veten dhe rrënjët tona dhe të shoqërisë dhe shtetit jodemokratik, na bën të sfidojmë narrativat e vjetra drejt të vërtetave që na rrisin.*

AIDSSH po riaktivizon procesin e kujtesës personale, familjare dhe shoqërore duke evokuar emocionet që rijetohen, që janë edhe të hidhura, të bukura, utopike apo dhe nostalgjike. Sidoqoftë respektimi i dhimbjes së tjetrit është një nga detyrat tona më të larta morale njerëzore.

Le të shpjerë ky rilexim i burimeve historike, dhe ky riaktivizim i kujtesës në një përkujtim që priret drejt empatisë, të vërtetës, përndërimit të vlerave demokratike, atdhedashese dhe njerëzore që kurrë nuk reshtën.

Kjo është sfidë morale e shoqërisë sonë vlerat etike të së cilës duhet të rindërtohen për një të ardhme të shëndoshë dhe demokratike të vendit.

Ju faleminderit!

18.07.2024

